

**Vendim nr. 139 datë 24.06.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marjana Semini, Anëtare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 24.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (B) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE: BARDHA SOKOLI**

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 7488, datë 01.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2063, datë 13.05.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 466, datë 09.03.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2016-494, datë 25.02.2016 dhe nr. 00-2023-813, datë 15.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 167, datë 22.09.2016 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 9, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 3 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollin nr. 12 i saj; nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## I

### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka qenë e punësuar në pozicionin e inxhinieres kimiste në Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve, Bashkia Kamëz. Me urdhrin nr. 256 prot., datë 31.05.2012, ndaj saj është dhënë masa disiplinore e uljes në detyrë me motivacionin e thyerjes së disiplinës në punë, për pasojë ajo është caktuar në pozicionin e faturistes në ndërmarrje.

2. Me pretendimin se ulja në detyrë ishte e padrejtë, kërkuesja ka ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, marrjen e diferencës së pagës për shkak të ndryshimit të pozicionit të punës dhe shpërblimin e dëmit të pësuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7488, datë 01.07.2013, ka vendosur pranimin e padisë vetëm për kërkimin e shpërblimit të dëmit.

3. Kundër vendimit ka paraqitur ankim Bashkia Kamëz. Me vendimin nr. 466, datë 09.03.2015, Gjykata Administrative e Apelit, së cilës i janë dërguar aktet për kompetencë nga Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin tërësisht të padisë.

4. Ndonëse kërkuesja ka paraqitur rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-494, datë 25.02.2016, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

5. Në datën 30.06.2016 kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, që nuk kishin pranuar padinë e saj. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 167, datë 22.09.2016, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

6. Ndërkohë, një muaj përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual, konkretisht në datën 30.05.2016, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit të saj për mospranimin e rekursit. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-813, datë 15.03.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës.

7. Në datën 12.03.2024 kërkuesja, i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.04.2024.

## II

### Pretendimet e kërkueses

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se prej vendimeve të kundërshtuara i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 8.1. *E drejta për një gjykatë të paanshme*, pasi gjykatat e zakonshme dhe Kolegji i Gjykatës janë ndikuar nga Bashkia Kamëz dhe kanë mbajtur anën e shtetit. Vendimet janë marrë nën ndikimin e ndërhyrjeve dhe presionit shtetëror.
- 8.2. *E drejta për një gjykim publik*, pasi gjykimi në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomën e këshillimit, mbi bazën e dokumenteve dhe pa regjistrim audio. Si rezultat, kërkesja nuk është thirrur të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes së saj, duke iu shkelur edhe të drejtat për t'u dëgjuar dhe mbrojtur.
- 8.3. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi duke mos u thirrur në proces, kërkesja nuk ka pasur mundësi të përballet me palën kundërshtare. Gjykatat nuk i kanë vënë kërkueses në dispozicion provat shkresore të paraqitura në gjykim nga pala tjetër.
- 8.4. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës kërkesja është ulur në detyrë për shkak të bindjeve politike opozitare të saj.
- 8.5. *E drejta për një gjykim të drejtë*, pasi vendimet e kundërshtuara, përfshirë vendimin e mëparshëm të Kolegjit të Gjykatës, janë të padrejta dhe në shkelje të ligjit, si dhe nuk kanë zgjidhur çështjen në mënyrë përfundimtare.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Kolegji vëren se në rastin e ankimeve kushtetuese individuale të përsëritura, një prej kriterëve paraprake përcaktohet nga shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, sipas së cilës kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, kërkesja i është drejtuar Gjykatës për herë të parë në vitin 2016, duke kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit ishte rrëzuar padia e saj për marrëdhëniet e punësimit, duke parashtruar si shkaqe cenimin e së drejtës për një gjykatë të paanshme, parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit dhe së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 167, datë 22.09.2016, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se pretendimet ishin haptazi të pabazuara. Nga ana tjetër, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me

kërkesë për rishikimin e vendimit për mospranimin e rekursit të saj. Gjykata e Lartë, me vendimin, datë 15.03.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se ajo ishte e pabazuar në ligj. Në këto rrethana, kërkuësja i është drejtuar për herë të dytë Gjykatës, duke kundërshtuar procesin gjyqësor në të cilin ishte rrëzuar padia e saj për marrëdhëniet e punësimit, si dhe vendimin e Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim.

11. Duke iu referuar standardit kushtetues për paraqitjen e një ankimi të ri kushtetues nga i njëjti individ, Kolegji çmon se, në rastin konkret, duhet verifikuar nëse plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: (i) nëse kërkuësja ka paraqitur shkaqe të reja kushtetuese; (ii) dhe nëse ankimi i dytë është paraqitur prej saj brenda afatit ligjor.

12. Lidhur me shkaqet e ankimit, Kolegji vëren se kërkuësja ka paraqitur, ndër të tjera, edhe pretendimet për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe së drejtës për gjykim publik, të cilat nuk ishin parashtruar prej saj në ankimin e parë. Për rrjedhojë, për këto dy pretendime të reja ankimi e plotëson kushtin e shkaqeve të reja kushtetuese.

13. Për sa i takon afatit, Kolegji vëren se për ankimet kushtetuese individuale të paraqitura pas datës 01.03.2017, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 86, pika 3, të ligjit nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577/2000”, afati është shkurtuar nga 2 vjet në 4 muaj. Lidhur me llogaritjen e afatit, Gjykata është shprehur se kur kundërshtohen vendimet e Gjykatës së Lartë, ai fillon nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen konkrete, kërkuësja ka paraqitur për herë të dytë ankim për kundërshtimin e procesit gjyqësor, në të cilin është rrëzuar padia e saj për marrëdhëniet e punës. Procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar me vendimin nr. 00-2016-494, datë 25.02.2016 të Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 00-2023-813, datë 15.03.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të mospranimit të rekursit, i cili është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 20.04.2023, ndërkohë ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 12.03.2024, pra pas 7 vjetëve nga përfundimi i procesit gjyqësor për marrëdhëniet e punës dhe pas më shumë se 10 muajve nga dhënia e vendimit për mospranimin e kërkesës për rishikim.

15. Kolegji thekson se paraqitja e një kërkesë për rishikim që nuk pranohet nga gjykata nuk përcakton ditën se kur bëhet përfundimtar vendimi gjyqësor i themelit që kërkohet të rishikohet, me qëllim përllogaritjen e afatit ligjor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Kërkesa për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një mjet i jashtëzakonshëm

ankimi, kur nuk pranohet nga gjykata, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të një procesi gjyqësor. Ashtu siç individëve iu kërkohet që për efekte të shterimit të mjeteve juridike të përdorin vetëm mjetet normale të ankimit, duke mos i detyruar të përdorin mjete të jashtëzakonshme ankimi (sikurse është edhe kërkesa për rishikim), në të njëjtën linjë, ata nuk mund të pretendojnë përmbushjen e afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimeve kushtetuese individuale, duke u bazuar në përdorimin e mjeteve të jashtëzakonshme të ankimit, të cilat janë refuzuar nga gjykata, si haptazi të pabazuara në ligj (*shih vendimin nr. 12, datë 02.02.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimet e reja të kërkueses ndaj procesit gjyqësor të vitit 2016 që lidhen me marrëdhënien e punësimit, janë paraqitur haptazi jashtë afatit ligjor. Po kështu, edhe pretendimet që lidhen me vendimin e mospranimit të kërkesës për rishikim janë paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë Kolegji çmon se kërkesa është e papajtueshme *ratione temporis*, ndaj duhet vendosur moskalimi i saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç” dhe “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.